



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
MINISTRIA E DREJTËSISË
DREJTORIA E PËRGJITHSHME E PËRMBARIMIT
ZYRA PËRMBARIMORE LUSHNJE

Nr. 574 Regj

Lushnje, më 06.10.2021

VENDIM – SHPALLJE

(Lidhur me ekzekutimin e “Urdhërit të Ekzekutimit” të titullit ekzekutiv të debitorit)

Në Lushnje, sot më datë 06.10.2021,
Unë Brikena Luto, me detyrë Përmbaues Gjyqësor pranë Zyrës së Përmbaimit Lushnje, pasi studiova aktet procedurale të çështjes përmbaimore nr.574, datë 13.09.2021 bazuar në urdhërin e ekzekutimit datë 03.09.2021 të Prokurorisë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë Tiranë,

K O N S T A T O V A :

Se në datë 13.09.2021 është depozituar pranë Zyrës së Përmbaimit Lushnje kërkesa e kreditorit Prokurorisë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë Tiranë së bashku me “ Urdhërin e Ekzekutimit ” datë 03.09.2021 të Prokurorisë Pranë Gjykatës së Shkallës së Parë Tiranë për vendimin me nr.1865, datë 22.06.2021 të Gjykatës së Shkallës së Shkallës së Parë Tiranë me palë:

- Kreditor : Buxheti i Shtetit
- Debitor : Mark Martin Marku
- Objekti : Gjobë penale

Nga ana e Zyrës së Përmbaimit Lushnje ka filluar procedurat në bazë të nenit 515 e vijues të K.Pr. Civile si dhe ligjit nr. 8730, datë 18.01.2001 “ Për Organizimin dhe Funksionimin e Shërbimit Përmbaimit Gjyqësor”, i ndryshuar për ekzekutimin e detyrueshëm të titullit ekzekutiv të sipërcituar.Nga verifikimi i kryer nga ana jonë në bashkëpunim me organet kompetente, rezulton se debitori Mark Martin Marku nuk ka marr dijeni nëpërmjet shërbimit postar, si rezultat i kësaj bazuar në nenet 133/a, 133/b dhe 144/a si dhe neni 517 të Kodit të Procedurës Civile duhet të bëhet njoftimi me shpallje publike e debitorit lidhur me detyrimin që ka ai ndaj palës kreditore Buxhtetit të Shtetit për shpenzime procedurale në vlerën 89 600 lekë.

Sa më sipër në mbështetje të nenit 133/a, 133/b, dhe 144/a si dhe 517 të Kodit të Procedurës Civile dhe ligjit nr.8730, datë 18.01.2001 “ Për Organizimin dhe Funksionimin e Shërbimit Përmbaimit Gjyqësor”, i ndryshuar.

VENDOSA :

1. Të kryej njoftimin nëpërmjet shpalljes publike me afat 20 (njëzet) ditor (duke marr parasysh edhe komunimin postar), nga data 07.10.2021 – 26.10.2021 të debitorit Mark Martin Marku;
2. Ky vendim përpilohet në disa kopje, ku një kopje afishohet në këndin e njoftimit të Zyrës së Përmbarrimit Lushnje, një kopje dërgohet për afishim pranë në këndin e publikimeve të Bashkisë Lushnje, një kopje dërgohet për afishim në ambjentet e Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Lushnje dhe një kopje dërgohet për publikim në faqen zyrtare të Drejtorisë së Përgjithshme të Përmbarrimit Tiranë.
3. Kjo shpallje publike ka vlerën e aktit të njoftimit për palën debitore Mark Martin Marku me banim në rrugën “Misto Mame”, Nd.5, H.2, Ap.1, Bashkia Lushnje;
4. Pala debitore Mark Martin Marku me banim në rrugën “Misto Mame”, Nd.5, H.2, Ap.1, Lushnje të paraqitet pranë Zyrës së Përmbarrimit Lushnje në lagjen “Çlirim” , kati i parë, hyrja mbarapa në ambjentet e Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Lushnje dhe të marr kontaktet me përmbarruesin gjyqësor të çështjes përmbarrimore për t’iu vënë në dispozicion aktet e dosjes përmbarrimore, pasi me kalimin e këtij afati do të vijohet me ekzekutim detyruar sipas nenit 519 e ne vijim të Kodit të Procedurës Civile.

U shpall në Lushnje, sot më datë 06.10.2021.

PËRMBARRUESI GJYQËSOR

Brikena Lulo

